



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:104053

Datë: 18.04.2023

Numri i dokumentit: 04195539

PS.nr.14/2021

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti Special Kryetari i Trupit Gjykesgjyqtari Lutfi Shala, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Luljeta Gashi Metaj, duke vendosur sipas aktakuzës së ish Zyrës së Prokurorit Publik- Prishtinë tani Prokuroria Speciale PP.nr.SEK 65/2005 datë 05.10.2006 në çështjen penale kundër të akuzuarve R. R. nga M. e B. banor në F. C., P. L.P. R., për shkak të veprës penale Lidhja e kontratave të dëmshme në kundërshtim me nenin 237 të KPPK, dhe R.S. nga N. banor në O. S.15 B, i akuzuar për shkak të veprave penale Ndhimë në Lidhjen e kontratave të dëmshme në pajtim me nenin 25 të KPPK, duke vendosur sipas detyrës zyrtare jashtë seance gjyqësore, me datë 12.04.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

HUDHET aktakuza e ish Zyrës së Prokurorit Publik në Prishtinë tani Prokuroria Speciale PP.nr.SEK 65/2005 datë 05.10.2006, **PUSHOHET** procedura penale kundër të pandehurve Mbretëria e Bashkuar banor në Flint Cottage, Pict Lane Princes Risborough për shkak të veprës penale Lidhja e kontratave të dëmshme në kundërshtim me nenin 237 të KPPK-së dhe R.Snga Nrvegjia banor në Oslo Stovnerfaret 15 B, i akuzuar për shkak të veprave penale Ndhimë në Lidhjen e kontratave të dëmshme në pajtim me nenin 25 të KPPK-së, pasi që ka arritur **parashkrimi absolut** i ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale paguhen nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Pala e dëmtuar PTK, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike, udhëzohet në kontest civil.

A r s y e t i m

Ish Prokuroria Publike në Prishtinë tani Prokuroria Speciale në Prishtinë, ka paraqitur akuzën PP.nr.SEK 65/2005 datë 05.10.2006, kundër të akuzuarve R.Gnga Mbretëria e Bashkuar banor në F.C., P. L.Princes R. për shkak të veprës penale Lidhja e kontratave të dëmshme në kundërshtim me nenin 237 të KPPK-së dhe R.S nga N. banor në O. S.nr. B, i akuzuar për shkak të veprave penale Ndhimë në Lidhjen e kontratave të dëmshme në pajtim me nenin 25 të KPPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale fillimisht hetimet janë zbatuar nga Prokurori Publik Ndërkombëtar nga UNMIK=ku më pastaj është transferuar tek gjyqtarët e EULEX, më pastaj EULEX ka transferuar lëndën tek gjyqtarët vendor.

Lënda në gjykatë është pranuar me datë ..., ndërsa në zyrën e gjyqtarit të çështjes është pranuar me datë

Gjykata konstaton se në shkresat e lëndës ka prova që ndaj të akuzuarve është lëshuar urdhër Arresti, letë rreshtimi vendor, letër rreshtimi ndërkombëtar, dhe së fundmi me dt: ..., është bërë kërkesë për të transferuar lëndën në shtetet përkatëse ku të akuzuarit e kanë vendbanimin, mirëpo gjykata nuk ka prova

se të njëjtit janë gjykuar në vendet e tyre edhe pse pas pranimit të kësaj lënde gjyqtari ka kërkuar informacion nga Prokuroria Speciale dhe po ashtu nga Zyra për Bashkëpunim Juridik Ndërkombëtar pranë MD-së, mirëpo të njëjtit nuk kanë siguruar informacion se çka është vendos lidhur me këtë çështje.

Kryetari i trupit gjykues pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare ka konstatuar se ka ardhur deri te parashkrimi absolut i ndjekjes penale, dhe pasi që veprat penale Lidhja e kontratave të dëmshme në kundërshtim me nenin 237 të KPPK-së dhe Ndihmë në Lidhjen e kontratave të dëmshme në pajtim me nenin 25 të KPPK-së, janë kryer me datë, ndërsa për këtë vepër penale ligjvënësi ka paraparë dënim me burgim prej gjatë (1) deri në pesë(10) vjet.

Meqenëse vepra penale është kryer me datën .. e sipas dispozitave të nenit 237 par. 2 të KPK-së, ligjvënësi ka paraparë dënim me burgim prej gjatë (1) deri në pesë(10) vjet, gjykata pasi shqyrtoi dhe vlerësoj shkresat e lëndës dhe duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në rastin konkret është shkaktuar parashkrimi absolut dhe ndalesa absolute e ndjekjes penale, ngase sipas dispozitave të nenit 90 par. 1 nen par. 1.3 të KPK-së, vepra penale e cila është e dënueshme më me shumë se pesë (5) vjet burgim parashkruhet kur të kalojnë 10 vite nga data e kryerjes, kurse sipas dispozitave të nenit 91 par. 6 të KPK-së, ndjeka penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, që në rastin konkret kane kaluar më shumë se 20 vite.

Vendimi lidhur me kompensimin e shpenzimeve të procedurës penale është marrë në bazë të nenit 453 par.1 të KPPRK-së.

Konform nenit 457 të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil.

Nga të dhënat e paraqitura më lartë gjykata konstaton se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore që kundër të akuzuarve të hedhet akuza dhe të pushohet procedura penale, prandaj në vështrim të nenit 90 par 1 nën par.3, si dhe nenin 91 par. 6 të KPPK-së, si dhe nenit 248 par 1 nën par. 1.3 të KPPRK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARAMENTI SPECIAL
PS.nr.14/2021, datë 12.04.2023

Kryetari i trupit gjykues
Lutfi SHALA

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, është e lejuar ankesa, brenda tri (3) ditësh, nga dita e dorëzimit të kopjes së aktvendimit. Ankesa i dorëzohet kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.